

## FIREARMS

**Nexhmedin Sejdiu**

College Biznesi, Faculty of Law, Prishtina, Kosovo, [nexhmedinsejdiu@outlook.com](mailto:nexhmedinsejdiu@outlook.com)

**Abstract:** Every weapon that is produced, every warship launched in use, every missile fired, in the final sense means theft from those who are hungry and not fed, those who are cold and not dressed. - Dwight D. Eisenhower. I have never supported war, except as a means to peace. - Ulysses S. Grant. I am starting this paper with these very valuable sayings as weapons are not good to use but in some cases they are very valuable and are quite important for the security of the country. The beginning of the use of firearms is very early, it is closely related to the discovery of gunpowder, which was accidentally discovered in ancient China and then to its introduction into use in the manufacture of weapons. Over time guns have evolved from mechanically produced by hand to production now with the most sophisticated technology. As far as weapons are concerned, they are divided into different categories, which I will address below, as well as which weapons are considered the most dangerous in the world, how our legislation regulates who can be the possessor of weapons, and why in Kosovo has many illegal possession of weapons will be some of the main focus points of this paper.

**Keywords:** Weapons, Law, Crime, Confiscation, Legalization.

## ARMËT E ZJARRIT

**Nexhmedin Sejdiu**

Kolegji BIZNESI- Fakulteti Juridik, Prishtinë, Kosovë, [nexhmedinsejdiu@outlook.com](mailto:nexhmedinsejdiu@outlook.com)

**Abstrakt:** Çdo armë që është prodhuar, çdo anije luftarake e lëshuar në përdorim, çdo raketë e gjuajtur, në kuptimin final nënkupton vjedhje nga ata që kanë uri dhe nuk janë të ushqyer, ata që kanë të ftohtë dhe nuk janë të veshur. – Dwight D. Eisenhower.<sup>93</sup> Asnjëherë nuk kam përkrahur luftën, përveç si mjet për paqe. – Ulysses S. Grant. Po e filloj këtë punim me këto thënje shumë me vlerë pasi armët nuk janë të mira të përdoren por në disa raste janë shumë me vlerë dhe janë mjaft me rëndësi për sigurinë e vendit. Fillimi i përdorimit të armëve të zjarrit është shumë i hershëm, ai është i lidhur ngushtë me zbulimin e barotit, i cili është zbuluar aksidentalisht në Kinën e lashtë e pastaj me futjen e tij në përdorim në prodhim të armëve. Me kalimin e kohës armët kanë evoluar nga prodhimi me dorë në mënyrë mekanike në prodhim tani me teknologjinë më të sofistikuar. Sa i takon armëve ato ndahen në kategori të ndryshme të cilat do të trajtoj në vazhdim, poashtu edhe se cilat armë konsiderohen si më të rrezikshmet në botë, si e rregullon legjislacioni i jonë se kush mundet të jetë posedues i armëve, si dhe pse në Kosovë ka shumë armë mbajtje pa leje do të janë disa nga pikat kryesore të fokusit të këtij punimi.

**Fjalët kyçe:** Armët, Ligji, Kriminaliteti, Konfiskimi, Legalizimi.

### 1. SHKENCA MBI ARMËT E ZJARRIT “BALISTIKA”

Shkenca e cila i studion armët quhet Balistika . Fjala balistikë rrjedh nga gjuha Greke (“ballo’ që do të thotë” të hedhësh”). Balistika është shkenca mbi lëvizjen e trupave të hedhur në përgjithësi pra lëvizjen e predhes në tytë dhe jashtë saj. Balistika kriminalistike studion metodat dhe mjetet teknike-shkencore, për zbulimin , fiksimin, ekzaminimin e gjurmëve të lëna nga armët e zjarrit, nga municioni që është përdorur prej tyre, për identifikimin e armës së zjarrit në bazë të gëzhgojes së predhës si dhe metodat e mjetet për caktimin e gjendjes teknike të armës së zjarrit dhe të fenomeneve të qitjes me qëllim që të zgjidhin problemet që lindin në hetimin dhe gjykimin e çështjes penale.

Problemet që mund të zgjidhen me anë të balistikës lidhen me gjendjen e armës së zjarrit-provë material:

- Identifikimin grupor dhe individual të të armës së zjarrit;
- të gëzhgojes;
- të predhave;
- të municionit;
- të sacmave;
- Rrethanave të qitjes(koha, lartësia, drejtimi,vendi I ndodhjes së qitësit dhe të viktimave, vrima e hyrjes dhe e daljes në trupin e viktimes ose në sendet e vendit të ngjarjes, numri i qitjeve dhe rradhen e tyre).

<sup>93</sup> <https://fjalaim.ch/200-thenie-mbi-luften/>

Balistika kriminale ndahet ne:

- a) **balistiken e brendshme** - e cila studion lëvizjen e predhës brenda tytës së armës të shtyrë nga trysnia e gazrave të barotit;
- b) **balistiken e jashtme** - e studion lëvizjen e predhës prej daljes nga tyta deri te pika e fundit e rrugëtimit, apo deri te goditja e caktuar ose zbrërthimit te tij ne ajër dhe
- c) **balistiken terminale** – masen dhe shpejtësisë si dhe faktorët si forma e projektilit ne cak dhe lokacionin e goditjes.

## 2. KLASIFIKIMI I ARMËVE TË ZJARRIT

**Armë** - konsiderohet secili mjet ose vegël e punuar me qëllim që nën presionin e gazrave të cilat shkaktohen gjatë djegies së materialeve shpërthyes, elektricitetit, gazrave nën presion ose energjisë tjetër potenciale, të hedhë predha, grumbullit prej saçmash, gazi, lëngu, shigjete ose përbërësish të tjerë, që është e përcaktuar ose është përdorur për të shkakuar dëm trupor, dëm fizik, dëm psikologjik dhe po ashtu çdo mjet tjetër qëllimi i të cilit është të bëjë sulm fizik ndaj integritetit fizik të njerëzve ose pronës;<sup>94</sup>

**Armë e zjarrit** - çdo armë e bartshme me tytë që hedh, e cila është e projektuar për të hedhur apo mund të jetë e konvertuar për të hedhur predhë, saçmë apo diabolë nga veprimi i një shtytësi të djegshëm. Objekti konsiderohet si i aftë për tu konvertuar, nëse plotëson kushtet si në vijim: ka pamjen e armës së zjarrit ose si rezultat i konstruksionit apo për shkak të strukturës së materialit, mund të konvertohet në armë zjarri;

Armët e zjarrit mund të klasifikohen sipas kriterëve të ndryshme. Në bazë të mekanizmit të punës-ato ndahen në:

- Mekanike (respektuara)
- Gjysmë-automatike
- Automatike.

**Armët mekanike** – për të arritur deri te ndezja e cdo predhe duhet të ndërmerjen operacione mekanike , me të cilat predha futet në tytë , ndizet dhe e hedh jashtë gëzhojen e ndezur.



95

**Armët gjysmëautomatike**- te këto armë mjafton që vetëm predha e parë të futet në tytë e që më vonë në mënyrë suksesive të bëhet ndezja e të gjitha predhave .



96

**Armët automatike**- janë ato të cilat pas futjes së predhës të parë në tytë, ndezja e të gjitha predhave të mbetura bëhet në mënyrë automatike.

<sup>94</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=11018>

<sup>95</sup> Foto e armës mekanike [https://www.google.com/search?biw=1707&bih=821&tbn=isch&sa=1&ei=ZGMyXJz2A-StrgTUkrNI&q=pumparica+&oq=pumparica+&gs\\_l=img\\_3..012j0i3013j0i5i3014.391319.397523..399879...0.0.0.248.2736.2j18j2.....0....1..gws-wiz-img.....0..0i67j0i10.XQbto\\_tY444#imgrc=6z\\_6h9q5iR6zHM:](https://www.google.com/search?biw=1707&bih=821&tbn=isch&sa=1&ei=ZGMyXJz2A-StrgTUkrNI&q=pumparica+&oq=pumparica+&gs_l=img_3..012j0i3013j0i5i3014.391319.397523..399879...0.0.0.248.2736.2j18j2.....0....1..gws-wiz-img.....0..0i67j0i10.XQbto_tY444#imgrc=6z_6h9q5iR6zHM:)

<sup>96</sup> Foto e armës gjysmë automatike-pistoleta

[https://www.google.com/search?biw=1707&bih=821&tbn=isch&sa=1&ei=9GQyXMnhLurgTO-7cY&q=pistoleta+foto&oq=pistoleta+foto&gs\\_l=img\\_3..0i8i30.571657.580960..581819...3.0..0.165.2556.6j18.....0....1..gws-wiz-img.....0..0j0i30j0i5i30j0i67.Y7NkFayIMiY#imgdii=FNKA6nhltWIZM:&imgrc=QroF-YiUELPeZM:](https://www.google.com/search?biw=1707&bih=821&tbn=isch&sa=1&ei=9GQyXMnhLurgTO-7cY&q=pistoleta+foto&oq=pistoleta+foto&gs_l=img_3..0i8i30.571657.580960..581819...3.0..0.165.2556.6j18.....0....1..gws-wiz-img.....0..0j0i30j0i5i30j0i67.Y7NkFayIMiY#imgdii=FNKA6nhltWIZM:&imgrc=QroF-YiUELPeZM:)



### 3. LLOJET E LEJEVE PËR PERSONA FIZIK

Lejet për personat fizik janë:

1. leja për armëmbajtje të armës së zjarrit;
2. leja për armë koleksioni;
3. leja për armë gjahu;
4. leja për armë shenjëtarie; dhe
5. leja për armë të kategorisë D<sup>98</sup>

### 4. MBAJTJA NË PRONËSI, KONTROLL OSE POSEDIM TË PAAUTORIZUAR TË ARMËVE

Sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve është veprë penale dhe e dënueshme në bazë të nenit 374.

1. Kushdo që mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, dënohet me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7.500) Euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet.
2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni përfshin më shumë se katër (4) armë ose më shumë se katërqind (400) fishekë, kryesi dënohet me burgim prej dy (2) deri në dhjetë (10) vjet.
3. Arma në pronësi, kontroll apo posedim në shkelje të këtij neni konfiskohet.<sup>99</sup>

**Armët më të rrezikshme në botë**<sup>100</sup>Në forcat ushtarake, fuqia dhe rrezikshmëria e armëve është me rëndësi jetike, veçanërisht për trupat e këmbësorisë, prandaj këto të fundit gjithnjë synohet që të pajisen me pushkët e teknologjisë më të fundit, e cila është avancuar në mënyrë të theksuar në fund të shekullit të kaluar. Pushkët e para, që besohet të jenë përdorur rreth vitit 1000 të erës sonë në Kinë, ishin shumë të komplikuar për t'u përdorur e rimbushur dhe kishin një saktësi të ulët të goditjes së caktuar, por me kalimin e kohës këto të meta të tyre janë përmirësuar dukshëm. Rreth 100 vjet pas këtij përmirësimi, pushkët që janë rimbushur në mënyrë manuale janë shndërruar në plotësisht automatike dhe në ditët e sotme objektivi mund të qëllohet me pushkë snajper edhe nga distanca prej 1.8km.

#### Pushka snajper DSR-Precision DSR 50



101

<sup>97</sup> Foto e armëve

automatike [https://www.google.com/search?bi&=1707&bih=821&tbm=isch&sa=1&ei=O2cyXMT2Een6qwGM716YAg&q=armet+automatike&oq=armet+automatike&gs\\_l=img\\_3...362958.369886..370356...0.0..0.307.2655.3j18j0j1.....0....1..gws-wiz-img....0..0j0i8i30j0i10j0i30j0i24.a1bYgMM9chk#imgrc=Jy1N9OGZvCI2YM:](https://www.google.com/search?bi&=1707&bih=821&tbm=isch&sa=1&ei=O2cyXMT2Een6qwGM716YAg&q=armet+automatike&oq=armet+automatike&gs_l=img_3...362958.369886..370356...0.0..0.307.2655.3j18j0j1.....0....1..gws-wiz-img....0..0j0i8i30j0i10j0i30j0i24.a1bYgMM9chk#imgrc=Jy1N9OGZvCI2YM;)

<sup>98</sup> Po aty.

<sup>99</sup> Kodi Penal neni 374 <https://ëëë.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Kodi%20penal.pdf>

<sup>100</sup> <https://www.flurudha.com/2017/02/foto-njihuni-me-10-armet-me-te-rrezikshme-ne-bote-detaje/>

<sup>101</sup> <https://www.google.com/search?q=Pushka+snajper+DSR->

[Precision+DSR+50&tbm=isch&ved=2ahUKEwiy4dXZ9NvsAhVCNewKHV1bBaUQ2-](Precision+DSR+50&tbm=isch&ved=2ahUKEwiy4dXZ9NvsAhVCNewKHV1bBaUQ2-cCegQIABAA&oq=Pushka+snajper+DSR-)

<cCegQIABAA&oq=Pushka+snajper+DSR->

[Precision+DSR+50&gs\\_lcp=CgNpbWcQAzoCCAA6BAgAEB46BggAEAUQHIDwyv4ZYLPnGWgAcAB4A4ABhQKIA](Precision+DSR+50&gs_lcp=CgNpbWcQAzoCCAA6BAgAEB46BggAEAUQHIDwyv4ZYLPnGWgAcAB4A4ABhQKIA)

Kjo pushkë snajper e prodhuesit gjerman DSR-Precision GmbH, konsiderohet të jetë pushka numër një në botë për nga fuqia shkatërruese e dëmtuese dhe aktualisht pushka më e rrezikshme. Peshë (pa fishekë): 10.3 kg Gjatësia 135cm.

#### Heckler & Koch HK416



<sup>102</sup>Kjo është një pushkë sulmi e prodhuar në vitin 2004 nga kompania gjermane Heckler & Koch, e cila është përdorur me të madhe në luftën në Afganistan, luftën në Irak dhe në konfliktin në veri të Malit. Peshë(pa fishekë): 3 kg Gjatësia: 69 cm

**Mitralozi XM307 ACS-** XM307 ACSW është një armë amerikane me të cilën operojnë 2 ushtarë. Kjo makinë vdekjeprurëse që përdoret për të ndaluar trupat e këmbësorisë së armikut shkrepe 250 fishekë në minutë. Përveç që e ka të kompjuterizuar pajisjen e shënjestrimit, ky mitraloz ndër të tjera ka edhe hedhës granate dhe është shumë efikas edhe gjatë natës.



103

#### AK-47



104

Kallashnikov AK-47 është një nga pushkët më të përdorura dhe më të popullarizuara në botë. Për herë të parë kjo pushkë sulmi është prodhuar në vitin 1946 nga Mikhail Kallashnikov. Edhe sot e kësaj dite kjo pushkë e rrezikshme, me kosto të ulët, përdoret si armë kryesore e forcave të sigurisë.

[YQJkgEFMC42LjKYAQcAQGqAQtd3Mtd2l6LWltZ7ABAMABAQ&sclient=img&ei=kNCbX7LZMMLqsAfdtpWoCg&bih=781&biw=1700&rlz=1C1CHBF\\_enXK775XK775#imgrc=ZHrnXB0qN1WoWM](https://www.google.com/search?q=heckler+%26+koch+hk416&tbm=isch&ved=2ahUKEwjKsPKj9tvsAhXNkKQKHVnB6oQ2-cCegQIABAA&oeq=Heckler+%26+koch+hk41&gs_lcp=CgNpbWcQARgAMgIIADICCAyAggAMgIIADICCAyAggAMgIIADICCAyAggAMgIIAFDDhgNY8JUDYozLA2gAcAB4AIABtAGIAYsCkgEDMS4xmAEAoAEBggELZ3dzLXdpei1pbWwAQDAAQE&sclient=img&ei=ONKbX8q0Ns2hkgX1zp3QCg&bih=781&biw=1700&rlz=1C1CHBF_enXK775XK775)

<sup>102</sup>

[https://www.google.com/search?q=heckler+%26+koch+hk416&tbm=isch&ved=2ahUKEwjKsPKj9tvsAhXNkKQKHVnB6oQ2-cCegQIABAA&oeq=Heckler+%26+koch+hk41&gs\\_lcp=CgNpbWcQARgAMgIIADICCAyAggAMgIIADICCAyAggAMgIIADICCAyAggAMgIIAFDDhgNY8JUDYozLA2gAcAB4AIABtAGIAYsCkgEDMS4xmAEAoAEBggELZ3dzLXdpei1pbWwAQDAAQE&sclient=img&ei=ONKbX8q0Ns2hkgX1zp3QCg&bih=781&biw=1700&rlz=1C1CHBF\\_enXK775XK775](https://www.google.com/search?q=heckler+%26+koch+hk416&tbm=isch&ved=2ahUKEwjKsPKj9tvsAhXNkKQKHVnB6oQ2-cCegQIABAA&oeq=Heckler+%26+koch+hk41&gs_lcp=CgNpbWcQARgAMgIIADICCAyAggAMgIIADICCAyAggAMgIIADICCAyAggAMgIIAFDDhgNY8JUDYozLA2gAcAB4AIABtAGIAYsCkgEDMS4xmAEAoAEBggELZ3dzLXdpei1pbWwAQDAAQE&sclient=img&ei=ONKbX8q0Ns2hkgX1zp3QCg&bih=781&biw=1700&rlz=1C1CHBF_enXK775XK775)

<sup>103</sup> <https://www.pinterest.com/pin/443463894547665353/>

<sup>104</sup> <https://www.moviereplicasdirect.com/ak47-gold-assault-rifle-ak47-non-firing-replica.html>



#### FN F2000



F2000 FN është pushkë automatike sulmi shumë shkatërruese në luftë, që shkrepë 850 fishekë në minutë. Për herë të parë është prodhuar në vitin 2001 nga kompania belge FN Herstal. Peshë (pa fishekë): 3.9 kg Gjatësia: 68.8 cm.

#### Mitralozi MG3



MG3 është mitraloz i prodhuara në vitin 1960 nga prodhuesi gjerman Rheinmetall e që përdoret kryesisht në luftë për ta ndaluar përparimin e armikut. Ndonëse saktësia e tij është mjaft e ulët, ky mitraloz shkrepë 1,300 fishekë në minutë dhe është shumë efektiv në një distancë deri në 2000 metra. Peshë (pa fishekë-me trekëmbësh): 27.5 kg. Gjatësia: 1,097 mm.

#### Pushka snajper AS50



AS50 është pushkë snajper e prodhuar në vitin 2007 nga prodhuesi britanik i armëve të zjarrit Accuracy International. Me këtë pushkë, që shkrepë 5 fishekë në minutë, mund të qëllohen me saktësi të lartë objektivat në një distancë prej 1800 metra.

#### Uzi SMG



Uzi është karabinë automatike me plumba revoleje e projektuar nga majori izraelit, Uziel Gal në vitin 1948. Kjo karabinë, që shkrepë 600 fishekë në minutë, është shumë efektive për të qëlluar objektiva në distancë deri në 200 metra. Peshë (pa fishekë): 3.5 kg. Gjatësia: 445 mm.



**Heckler & Koch MG4**

MG4 është mitraloz i lehtë i prodhuar nga Heckler & Koch në vitin 1990 , ndërsa për herë të parë është parë publikisht në shtator të vitit 2001. Kjo armë vdekjeprurëse qëllon me sukses objektivat në distancë deri në 1,000 metra. Peshë(pa fishekë): 8.55 kg. Gjatësia: 1.050 mm.

**FN SCAR**



FN SCAR është pushkë sulmi në beteja, e projektuar në Belgjikë dhe e prodhuara në Shtetet e Bashkuara në vitin 2009 nga FNH SHBA. Kjo pushkë që është përdorur me të madhe në luftën afgane, shkrepe 625 fishekë në minutedhe me të mund të qëllohen me sukses objektivat në distancë deri në 600 metra. Peshë(pa fishekë): 3.49 kg. Gjatësia: 889 mm.

**Shpërndarja e përgjithshme e armëve:** Vlerësohet se nga qershori 2006 në Kosovë ka pasur rreth 400,000 armë. Nga të cilat: 33,936 armë të zjarrit janë në posedim të ligjshëm nga qytetarët individualë; 45,217 armë të zjarrit janë në duar të agjencive zyrtare dhe kompanive ndërkombëtare private të sigurimit; Së paku 317,000 armë të zjarrit janë në posedim të paligjshëm nga qytetarë dhe grupe të caktuara.<sup>105</sup>

## 5. VETËVRASJET

Të dhënat statistikore të Shërbimit Policor të Kosovës dhe të Policisë së UNMIK-ut rreth vetëvrasjeve dallojnë rrënjësisht. Të dhënat e SHPK-së tregojnë se në periudhën prej janarit të vitit 2000 deri në mars të vitit 2006 ka pasur 234 raste të vetëvrasjeve me armë zjarri. Në anën tjetër, të dhënat e Policisë së UNMIK-ut paraqesin vetëm 79 raste të vetëvrasjeve me armë gjatë periudhës prej janarit të vitit 2000 deri në prill të vitit 2006. Pastaj, të dhënat e UNMIK-ut tregojnë se në vitet 2004 dhe 2005 ka pasur gjithsej 11 raste të vetëvrasjeve me armë zjarri. Kjo përputhet me të dhënat e Policisë së UNMIK-ut për konfiskimet, sipas të cilave në vitin 2004 policia ka konfiskuar shtatë armë të vogla të përdorura në vetëvrasje dhe pesë të tjera në vitin 2005. Mediat e shkruara në Kosovë kanë raportuar për njëzet e katër vetëvrasje të kryera me armë të zjarrit në vitin 2005, si dhe kanë raportuar edhe për katër vetëvrasje të tjera me armë zjarri në mars të vitit 2006. Po ashtu disa të intervistuar për këtë hulumtim bënë komentet e tyre rreth vetëvrasjeve me armë zjarri. Sidoqoftë, shifrat e cituara më lartë nuk mundësojnë që të bëhet një krahasim i kënaqshëm i të dhënave në Kosovë me ato të vendeve të tjera në rajon ose në botë.

**Armët në vendet e dalura nga lufta:** Vendet e dalura nga lufta dhe vendet në tranzicion kanë predispozita që shoqëria civile të kanë në posedim në armë dhe municion në dispozicion në mënyrë të kundërligjshme pasi që ndjehen ende të pa sigurtë dhe në gjendje euforike. Po ashtu edhe Kosova menjëherë pas luftës kishte një gjendje alarmante të armëmbajtjes pa leje pasi që ishte një gjendje kaosi dhe njerëzit ishin ende të pasigurtë sepse që një periudhë të gjatë ishin nën sundimin e okupatorit Serb. Shumë armë gjendeshin në posedim nga qytetarët dhe me qëllim të largimit nga dora e popullit UNMIK-ut dhe të KFOR-it, por që nuk ishin mjaftë efektive sa duhej. Rolin kryesor në dorëzimin e armëve nga qytetarët e Republikës së Kosovës e ka Ministria e Punëve të Brendshme në bashkpunim me Policinë sepse me politikat e saj ka aarit që të grumbulloj numër të madhë të armëve si dhe të bëjë legalizimin e armëve të cilat i kanë në posedim qytetarët duke kontribuar kështu që të jetë nën kontroll numri i armëve dhe të dihet se kush është pronar i saj dhe të dihen specifikat e atyre personave.

<sup>105</sup> <https://www.seesac.org/f/docs/SALW-Surveys/SALW-Survey-of-Kosovo-ALB.pdf> fq. 13

## 6. PËRFUNDIM

Armët dhe posedimi i tyre nga persona jo adekuat, nga grupe kriminale, nga persona të mitur dhe nga persona që nuk kanë njohuri për rrezikun që mundet të shkaktohet nga mos pasja e njohurive se si duhet të manipulohet me armë me të është ndër çështjet kryesore që duhet të punohet që të luftohet tregu i zi i armëve, të ndalohen rrugët e kontrabandes me armë pasi që armët të cilat përdoren nga njerëzit të cilët nuk kanë leje për mbajtje të armës sjellin rrezik të madh të shoqërisë sepse në të shumten e rasteve ato përdoren për kryerje të veprave të ndryshme penale, e në disa raste nga personat që nuk dijnë të i përdorin ato pasi që edhe nuk kanë njohuri të mjaftueshme munden ta lëndojnë vetveten apo edhe të afërmit, për këtë arsye armët duhet të mbahen vetëm nga personat e licensuar, të cilët i kanë kaluar testimet fizike dhe psiqike dhe në mënyrë që të janë të matur dhe të vetdijshëm për veprimet që i ndërmerin.

## LITERATURA

[https://en.wikipedia.org/wiki/Dwight\\_D.\\_Eisenhower](https://en.wikipedia.org/wiki/Dwight_D._Eisenhower)

<https://fjalaime.ch/200-thenie-mbi-luften/>

Latifi.Vesel,Kriminalistika 2014, fq 551-553.

<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=11018>

[https://www.google.com/search?biw=1707&bih=821&tbm=isch&sa=1&ei=ZGMyXJz2A-StrgTUkrNI&q=pumparica+&oq=pumparica+&gs\\_l=img.3..0l2j0i30l3j0i5i30l4.391319.397523..399879...0.0.0.248.2736.2j18j2.....0....1..gws-wiz-img.....0..0i67j0i10.XQbto\\_tY444#imgrc=6z\\_6hyq5iR6zHM:](https://www.google.com/search?biw=1707&bih=821&tbm=isch&sa=1&ei=ZGMyXJz2A-StrgTUkrNI&q=pumparica+&oq=pumparica+&gs_l=img.3..0l2j0i30l3j0i5i30l4.391319.397523..399879...0.0.0.248.2736.2j18j2.....0....1..gws-wiz-img.....0..0i67j0i10.XQbto_tY444#imgrc=6z_6hyq5iR6zHM:)

<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=11018>

<https://www.flurudha.com/2017/02/foto-njihuni-me-10-armet-me-te-rrezikshme-ne-bote-detaje/>

Kodi Penal i Republikës së Kosovës i vitit 2019

<https://www.seesac.org/f/docs/SALW-Surveys/SALW-Survey-of-Kosovo-ALB.pdf>

<https://www.google.com/search?q=Pushka+snajper+DSR->

<Precision+DSR+50&tbm=isch&ved=2ahUKEwiy4dXZ9NvsAhVCNewKHV1bBaUQ2-cCegQIABAA&oq=Pushka+snajper+DSR->

[Precision+DSR+50&gs\\_lcp=CgNpbWcQAzoCCAA6BAgAEB46BggAEAUQHIDwywZYyt4ZYLPnGWgAcAB4A4ABhQKIAYQJkgEFMC42LjKYAQCgAQGqAQOnd3Mtd2l6LWltZ7ABAMABAQ&scient=img&ei=kNCbX7LZMMLqsAfdtpWoCg&bih=781&biw=1700&rlz=1C1CHBF\\_enXK775XK775#imgrc=ZHRnXB0qN1WoWM](Precision+DSR+50&gs_lcp=CgNpbWcQAzoCCAA6BAgAEB46BggAEAUQHIDwywZYyt4ZYLPnGWgAcAB4A4ABhQKIAYQJkgEFMC42LjKYAQCgAQGqAQOnd3Mtd2l6LWltZ7ABAMABAQ&scient=img&ei=kNCbX7LZMMLqsAfdtpWoCg&bih=781&biw=1700&rlz=1C1CHBF_enXK775XK775#imgrc=ZHRnXB0qN1WoWM)

<https://www.google.com/search?q=heckler+%26+koch+hk416&tbm=isch&ved=2ahUKEwjKsPKj9tvsAhXNkKOKHXVnB6oQ2->

[cCegQIABAA&oq=Heckler+%26+koch+hk41&gs\\_lcp=CgNpbWcQARgAMgIIADICCAAyAggAMgIADICCAAyAggAMgIIFDDhgNY8JUDYOzLA2gAcAB4AIABtAGIAYsCkgEDMS4xmAEAoAEBqgELZ3dzLXdpei1pbWewAQDAAQE&scient=img&ei=ONKbX8q0Ns2hkgX1zp3QCg&bih=781&biw=1700&rlz=1C1CHBF\\_enXK775XK775](cCegQIABAA&oq=Heckler+%26+koch+hk41&gs_lcp=CgNpbWcQARgAMgIIADICCAAyAggAMgIADICCAAyAggAMgIIADICCAAyAggAMgIIFDDhgNY8JUDYOzLA2gAcAB4AIABtAGIAYsCkgEDMS4xmAEAoAEBqgELZ3dzLXdpei1pbWewAQDAAQE&scient=img&ei=ONKbX8q0Ns2hkgX1zp3QCg&bih=781&biw=1700&rlz=1C1CHBF_enXK775XK775)

<https://www.pinterest.com/pin/443463894547665353/>

<https://www.moviereplicadirect.com/ak47-gold-assault-rifle-ak47-non-firing-replica.html>

<https://www.pinterest.com/pin/443463894547665353/>